

RAPORT PERIODIK, Nr. 2*
26 shkurt–10 mars 2009

I. REZYME

- Fushata zyrtare filloi më 2 mars me aktivitete politike intensive dhe shumë të theksuara mbarë gjithë vendit. Partitë dhe kandidatët mbajnë tubime të shumta, ndërsa mund të shihen edhe shumë tabela reklamuese dhe afishe. Çështjet lokale mbisundojnë gjatë fushatës.
- Kandidatët për president dhe liderët e partive bëjnë thirrje për zgjedhje të drejta dhe demokratike dhe publikisht u dërgojnë apel mbështetësve të tyre që t'iu shmangen incidenteve të cilat njollosën zgjedhjet e kaluara. Fjalori i përdorur gjatë fushatës është i qytetëruar dhe i matur. Tridhjetë e gjashtë parti politike kanë firmosur Kodin e mirësjelljes gjatë zgjedhjeve. Misioni për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ) i OSBE/ODIHR ka marrë njoftime për disa incidente të vogla zgjedhore.
- MVZ i OSBE/ODIHR vazhdon të marrë njoftime të shumta dhe të gjithanshme për shtypje apo frikësime të qytetarëve, veçanërisht të nëpunësve në shërbimin publik. MVZ ka hetuar këto pohime dhe disa nga to i ka konfirmuar.
- Përgatitjet për zgjedhjet kryesisht po zhvillohen sipas planit, përkundër faktit se puna e Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KShZ) është e vështirësuar si pasojë e mungesës të kuadrit profesional dhe të kualifikuar. Trajnimi i Komisioneve zgjedhore komunale (KZK) nuk u përfundua në kohë, dhe trajnimi i Këshillave zgjedhorë (KZ) është akoma në rrjedhë. Shtypja e fletëvotimeve po zhvillohet por me vonesë. Fushata për edukimin e votuesve nga KShZ nuk ka filluar akoma por pritet që kjo të ndodh gjatë ditëve në vijim.
- Mediat kanë përcjell gjerësisht fushatën dhe kandidatët në lajme dhe në programe të tjera. Dy TV kanale private kanë emituar debate me shtatë kandidatët për president. Televizioni publik siguron kohë emetimi falas për paraqitjen e kandidatëve presidencial dhe për kryetarë komunash. Deri tani, vetëm disa parti kanë përdorur në masë të madhe reklamat politike me pagesë.
- Gjykata administrative ka sjell vendime për 12 aktpadi që kanë të bëjnë me regjistrimin e kandidatëve. Disa padi për kundërvajtje të paraqitura nga KShZ-ja dhe Këshilli Radiodifuziv (KR) para fillimit zyrtar të fushatës akoma presin që Gjykata e Shkallës së Parë t'i marrë për shqyrtim.
- Nga 374 kandidatë për kryetarë komunash vetëm 14 janë femra. 33 kandidatë për kryetar të komunave janë nga komunitetet më të vogla etnike, dhe e shumta prej tyre u takojnë partive politike etnike. Kushtet ligjore për përfaqësim të grupeve etnike dhe përfaqësimin gjinorë në administratën zgjedhore, duket se janë plotësuar.
- Disa dënime u shqiptuan në rastet gjyqësore kundër disa individëve të akuzuar për shkelje penale gjatë zgjedhjeve të vitit 2008. Disa bashkëbisedues kanë shprehur dyshimin për motive politike gjatë shqyrtimit të këtyre rasteve, gjë që Qeveria fuqimisht e përgënjeshtroi.

* Verzioni i vetëm zyrtar i këtij dokumenti është verzioni në gjuhën angleze.

- Ministria për punë të brendshme ka hartuar plan nacional për siguri me qëllim që të sigurojë rendin publik në ditën e zgjedhjeve.

II. ATMOSFERA E FUSHATËS

MVZ i OSBE/ODIHR observoi disa raste fushate para fillimit të fushatës zyrtare më 2 mars, siç ishin paraqitja e sloganeve të disa kandidatëve për president, mbajtjen e konventave partiake me publicitet të madh, dhe paraqitja e disa afisheve. Megjithatë, bashkëbiseduesit nuk mendonin se kjo është një çështje për tu shqetësuar apo arsye për ankesë. KShZ-ja dhe KR shqyrtuan arsyshmërinë për të ndërmarrë masa ndaj konventave partiake dhe publicitetit që e shkaktuan, por vendosën mos ta bënin këtë, pjesërisht për shkak se nuk morrën asnjë ankesë kundër kësaj. Madje, dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me aktivitetet partiake apo parazgjedhore që lejohen para fillimit të fushatës zyrtare, janë të paqarta.

Që nga fillimi i fushatës zyrtare 19-ditore më 2 mars, partitë politike dhe kandidatët për president kanë filluar programe tubimesh tejet intensive. Gjatë periudhës të raportimit, MVZ i OSBE/ODIHR vëzhgoi afër 50 tubime, ku liderët partiak, kandidatët për president dhe për kryetarë komunash, dhe për këshille komunale shpeshherë paraqiteshin së bashku. Edhe përkaj nivelit të lartë të aktiviteteve nga kandidatët për president, fokusi i interesit në tërë vendin duket të përqëndrohet më tepër në çështjet lokale sesa në ato kombëtare. Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ të OSBE/ODIHR pohojnë që këto zgjedhje nuk kanë flakur nivel të lartë të interesimit tek votuesit; disa të tjerë deklarojnë që mund të jetë e vështirë të arrihet 40 për qind e jehonës së votuesve në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale.

Fushata është shumë e dukshme mbarë vendit, duke përfshirë përdorimin e gjerë të tabelave reklamuese si billboardet dhe afisheet, të cilat shpesh paraqiten edhe në vende jopërkatëse siç janë shenjat e komunikacionit. Në kundërshtim me nenin 79.1 nga Kodi Zgjedhor, aktivistë të disa partive kanë mënjeluar afisheet e kundërshtarëve, por deri më sot kjo nuk ka shkaktuar ndonjë incident. Disa kandidatë dhe parti i kanë thënë MVZ-së të OSBE/ODIHR se nuk do të përdorin tabela reklamuese dhe afishe dhe se do të mbështeten mbi një fushatë sy më sy, duke thënë se kjo bëhet pjesërisht për arsye të mungesës së mjeteve financiare. E shumta e partive dhe kandidatëve duket se zhvillojnë fushatat e tyre kryesisht para bashkësive të tyre etnike ose, në shumë raste, vetëm para bashkësive të tyre etnike.

Shumica e liderëve partiak dhe kandidatëve për president i kanë thënë MVZ-së të OSBE/ODIHR se nuk presin që do të ketë përsëritje të incidenteve të dhunshme që negativisht ndikuan zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008. Liderët kanë lëshuar deklaratave publike me apel për zgjedhje të qeta dhe demokratike. Shumica e pjesëmarrësve në zgjedhjet presidenciale dhe lokale kanë bërë përpjekje të qarta për të përdorur retorikë të qytetëruar dhe të matur në fushatë, megjithëse MVZ i OSBE/ODIHR ka qenë dëshmitar i përdorimit të deklaratave nacionaliste apo që çojnë drejt ndarjes në vija etnike.

Tridhjetë e gjashtë parti politike kanë firmosur "Kodin e mirësjelljes për zgjedhje të lira dhe të drejta presidenciale dhe lokale" i iniciuar nga Instituti Demokratik Nacional, OJQ ndërkombëtare me seli në Uashington, i cili u shpërnda nga mediat dhe u shoqërua me një fushatë të gjerë për zgjedhje të lira dhe të drejta. Veç kësaj, garuesit në disa komuna kanë rënë dakord për kodet e tyre të mirësjelljes. Derisa bashkëbiseduesit e MVZ të OSBE/ODIHR mbarë vendit vazhdojnë të shprehin përkushtimin e tyre për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, një proces i mbarë zgjedhor shpeshherë barazohet me një ambient pa dhunë, pa i kushtuar vëmendjen e duhur elementeve të tjerë të nevojshëm për një proces zgjedhor demokratik.

Takimi i fundit nga një seri takimesh mes liderëve të katër partive kryesore politike në lidhje me zgjedhjet u mbajt më 1 mars. Liderët e partive iu dhanë për detyrë koordinatorëve të grupeve parlamentare të bashkëpunojnë mes tyre për të siguruar zgjedhje demokratike, por koordinatorët nuk janë takuar akoma. Takimi i 1 marsit duket se nuk ka prodhuar marrëveshje të reja, megjithëse në takimet paraprake liderët e partive ranë dakord që të mos lejohet përdorimi i kamerave dhe celularëve me kamera në vendvotimet, me qëllim që të mbrohet fshehtësia e votimit dhe të parandalohen frikësimet dhe blerja e votave. Lideri i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), e lëshoi takimin e liderëve të partive në shenjë proteste kundër atë që ai e quajti, zbatim të njëanshëm të ligjit kundër disa aktivistëve të PDSH-së të akuzuar për involvim në incidentet e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2008.

Në një përpjekje tjetër për të promovuar një fushatë të qytetëruar, dy kandidatë për president kanë marrë iniciativën të mbledhin kundërshtarët në një takim të përbashkët.

Megjithatë, MVZ i OSBE/ODIHR ka vërejtur disa tensionime gjatë fushatës. Për shembull, në Gostivar, Dibër, dhe në Shkup në Komunën e Shuto Orizares kandidatët kanë hedhur akuza të rënda kundër njëri tjetrit. MVZ i OSBE/ODIHR ka marrë informacione për disa incidente në lidhje me zgjedhjet gjatë kësaj periudhe të raportimit, përfshirë edhe rrahje mes aktivistëve të kandidatit presidencial të pavarur Ljube Boshkoski dhe aktivistëve të partisë në qeveri Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), dëme të lehta në dy zyre të Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI) në rajonin e Gostivarit, njoftime për kërcënime kundër aktivistëve të partisë Demokracia e Re në Gostivar dhe njoftime për mosmarrëveshje mes anëtarëve të dy partive politike rrome.

MVZ i OSBE/ODIHR vazhdon të merr pohime të shumta dhe shqetësuese për presion apo frikësime që ushtrohen mbi qytetarët mbarë vendit në lidhje me zgjedhjet. Mes këtyre pohimeve për presion më të theksuara janë ato që ushtrohet mbi punonjësit e sektorit publik, veçanërisht mbi ata që punojnë me kontratë me afat të kufizuar, për të mbështetur partitë në qeveri. Mes tjerash, thuhet se nga këta individë kërkohet të sigurojnë lista me emra dhe të dhëna për kontakt të qytetarëve të tjerë të cilët zotohen të mbështesin kandidatët e partisë kryesore në pushtet. MVZ i OSBE/ODIHR ka hetuar këto pohime dhe disa nga to i ka konfirmuar si të besueshme. Disa bashkëbisedues kanë pohuar se politizimi i vazhdueshëm i sektorit publik, i cili punëson mbi 100.000 persona, dhe ndryshimet kadrovike të bazuara mbi përkatësinë politike, bëjnë që punonjësit e sektorit publik të jenë grup i ndjeshëm ndaj presioneve, në nivel kombëtar dhe atë lokal. Raporte të tjera thonë se pronarët e bizneseve kanë frikë se do të jenë objekt i inspektimit tatimore në rast se mbështesin partitë opozitare. Disa anëtarë të Këshillave zgjedhor raportohet se kanë frikë të punojnë si të tillë për shkak të frikës nga dhuna apo kërcnimet, ndërsa qytetarë të tjerë kanë raportuar të kenë frikë të dëshmojnë në gjykata për rastet në lidhje me zgjedhjet për shkak të frikës nga ndëshkimet.

Para shpalljes së zgjedhjeve, Qeveria lansoi një fushatë publicitare të shtrenjtë në mbështetje të politikave dhe programeve të saj. Megjithëse ato u ndërprejnë kur u shpallën zgjedhjet, në pajtim me nenin 84-a nga Kodi Zgjedhor, partitë opozitare dhe përfaqësuesit e mediave thonë se këto fushata ishin kaq të gjera dhe gjithëpërfshirëse sa që vazhdojnë të kenë ndikimin e tyre mbi fushatën zgjedhore dhe kanë bërë që shumë nga mediat të varen nga të ardhurat nga reklamat qeveritare.

Që nga shpallja e zgjedhjeve, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit në mënyrë aktive ka përkujtuar organet shtetërore dhe lokale t'u shmangen investimeve dhe kontratave të reja, punësimeve të reja, apo përdorimit të fondeve publike dhe pagesave të jashtëzakonshme

gjatë periudhës zgjedhore, siç parashihet në Ligjin për parandalim të korrupsionit. Komisioni ka pranuar dy raste të blerjes të supozuar të votave.

Për të siguruar se policia do të luaj rolin e duhur në mirëmbajtjen e rendit publik gjatë ditës së zgjedhjeve, Ministrisë për punë të brendshme i janë dorëzuar plane për siguri policore rajonale të cilat janë inkorporuar në planin kryesor policor për siguri gjatë zgjedhjeve. Plani ka për qëllim zbatimin e masave parandaluese, me prani më të theksuar të policisë në rajonet ku janë shënuar probleme gjatë zgjedhjeve në të kaluarën. E gjithë policia—përfshirë këtu edhe policët me veshje civile – dhe automjetet policore duhet të jenë qartë të shënuara gjatë ditës së zgjedhjeve. Njëzitet Alfa, njësi speciale të specializuara për luftë kundër krimit të organizuar por që gjatë zgjedhjeve të kaluara kanë qenë aktive në shumë pjesë të vendit kryesisht të banuara nga shqiptarë, këtë herë do të jenë të kufizuara në territorin e Shkupit dhe një grup do të vendoset në Kumanovë me, siç thuhet, aktivitete kundër krim. Plani gjithashtu përfshin edhe shoqërimin dhe sigurimin e kutive të votimit, si dhe sigurinë e vendvotimeve, zyrat e KZK-ve dhe zyrës të KShZ-së. Plani është mbështetur nga një program për trajnimin e policisë mbi rolin e policisë gjatë zgjedhjeve.

Rastet gjyqësore kundër dhe përndjekja e personave që janë paditur për shkelje penale për zgjedhjet e vitit 2008 vazhdojnë. Disa dënime të reja janë shqiptuar, duke përfshirë shtatë dënime me burg, me çka numri i të dënuarve për shkelje penale gjatë zgjedhjeve të vitit 2008 u rrit në 25 persona. Disa bashkëbisedues – përfshirë këtu edhe liderët e dy partive opozitare – i thanë MVZ të OSBE/ODIHR se besojnë që rastet janë trajtuar ndryshe varësisht nga përkatësia partiake e të akuzuarve; Qeveria ka mohuar fuqimisht këto pohime. Bashkëbiseduesit gjithashtu kanë theksuar se një nga pengesat kryesore në procesimin e disa rasteve është se vetë dëshmitarët frikohen të dëshmojnë apo të mbështesin dëshmitë e tyre paraprake.

Rregulloret për financimin e fushatave u përmirësuan me amendamentet e fundit në Kodin Zgjedhor por edhe më tej mungojnë mekanizmat efektiv për zbatimin dhe kontrollin e tyre. Përveç kësaj, disa kontribute për fushatat zgjedhore (sigurimi i prodhimeve dhe shërbimeve që ofrohen me kosto më të ulët se ajo në treg) nuk hynë në kufizimet e definuara nga Kodi, me çka në mënyrë efikase anashkalohen kufijtë për donacionet për fushata.

Një numër shqetësues i kandidatëve dhe liderëve të partive politike i kanë thënë MVZ të OSBE/ODIHR-së se presin që në ditën e zgjedhjeve të ketë përpjekje për mashtrime.

III. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Në përgjithësi përgatitjet për zgjedhjet presidenciale dhe lokale të 22 marsit 2009, duket se po zhvillohen sipas planit, përkundër faktit që puna e Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KShZ) është e vështirësuar si pasojë e mungesës të kuadrit profesional dhe të kualifikuar. Me disa përjashtime, kandidatët dhe liderët e partive politike vazhdojnë të shprehin besimin e tyre në ndershmërinë dhe objektivitetin e KShZ-së dhe në nivelet më të ulëta të administratës zgjedhore. KShZ-ja vazhdon të punojë në mënyrë transparente dhe me frymë konsensusi.

KShZ-ja ka adoptuar një Doracak për edukimin e organeve zgjedhore. Megjithëse ky është një dokument shumë i nevojshëm, ai nuk është dhe aq i dobishëm sa mund të jetë si një udhëzues i vërtet, sepse në shumë raste thjesht përsërit dispozitat ligjore dhe nuk elaboron procedurat zgjedhore në mënyrë të detajuar. Doracaku nganjëherë nuk është konzistent, ose është në kundërshtim me disa udhëzime paraprake të KShZ-së, si për shembull në lidhje me votimin e personave të sëmurë dhe të paaftë, dhe ka boshllëqe në shpjegimin se si duhet të veprojnë KZ-të në disa rrethana të caktuara që mund të ndodhin. Trajnimi obligativ i KZ-ve vazhdon, trajnimi i KZK-ve përfundoi, por përtej afatit.

Shtypja e fletëvotimeve është akoma në rrjedhë e sipër, edhe pse me pak vonesë. Shtypja e fletëvotimeve për zgjedhjet presidenciale dhe për zgjedhjet lokale në disa komuna ka përfunduar. Edhe pse fletëvotimet për shumë komuna duhej të kalonin procesin e aprovimit nga KShZ-ja gjatë periudhës së raportimit, KShZ-ja beson se i gjithë materiali zgjedhor do të jetë gati dhe do t'u dorëzohet KZK-ve dhe KZ-ve në kohë të duhur.

Ekstraktet nga listat zgjedhore që do përdoren nga KZ-të në ditën e zgjedhjeve u firmosën nga KShZ-ja deri më 7 mars. MVZ i OSBE/ODIHR vazhdon të pranojë shprehje të shqetësimeve se prezenca e emrave të shumë qytetarëve në listat zgjedhore që janë jashtë vendit mund të rezultojnë me tentime për manipulime në ditën e zgjedhjeve. Edhe pse janë bërë tentime për të identifikuar këta votues, dhe tani ka një shenjë ylli pranë emrave të votuesve që nga autoritetet janë regjistruar si banorë që jetojnë jashtë vendit, kjo dukshëm përfshin vetëm një pjesë të vogël të personave që janë jashtë vendit. Shqetësimet mbi listën e votuesve janë të ndërlikuara ngase nuk ka vlerësime dhe kalkulime të sakta se sa qytetarë momentalisht ndodhen jashtë vendit.

Megjithëse me ligj KShZ është përgjegjës për të zbatuar edukimin e votuesve, ai deri më 10 mars akoma nuk kishte lansuar fushatën për edukimin e votuesve. KShZ ka njoftuar MVZ e OSBE/ODIHR se tanimë ka kontraktuar një agjenci reklamuese dhe se fushata në media do të fillojë deri në mes të muait mars. Në ditën e zgjedhjeve, udhëzime se si duhet votuar do të shpallen në dhe rreth vendvotimeve.

Pas ndryshimit të përbërjes së KZ-ve, me vetëm tre, nga gjithsej pesë anëtarë, të zgjedhur rastësisht nga rradhët e punonjësve publik, shumë pak anëtarë të KZ-ve do të punojnë larg vendit ku jetojnë. KShZ-ja informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR se vetëm rreth 100 persona janë të prekur nga kjo, shumica e të cilëve janë regjistruar vetëm disa kilometra nga vendvotimi ku do të punojnë dhe kështu ata anëtarë të KZ-ve do të kenë mundësinë të votojnë.

Pas rekomandimit nga partitë më të mëdha politike, KShZ miratoi udhëzimin për ndalimin e përdorimit të kamerave dhe celularëve për të fotografuar brenda vendvotimit. Megjithatë, administratorët zgjedhorë janë skeptik se përdorimi i telefonave do të mund të ndalohet në praktikë.

IV. MEDIAT

Në udhëzimet e Këshillit Radiodifuziv (KR) për periudhën që i paraprinte fushatës zyrtare thuhej se mediat elektronike duhet të paraqesin aktivitetet zgjedhore vetëm në kuadër të edicioneve të lajmeve dhe nuk duhet të emitojnë mbulime tjera në lidhje me zgjedhjet, si për shembull, intervista me kandidatët. Mediat elektronike në përgjithësi vepruan në pajtim me këto udhëzime, veçanërisht pasi që KR lëshoi paralajmërime dhe vërejtje dhe ngriti padi kundërvajtëse kundër disa mediave.

MVZ i OSBE/ODIHR analizoi dy javë raportimin e mediave para fillimit të fushës zyrtare (16 shkurt - 1 mars). Edhe pse nuk ekziston kusht ligjor gjatë kësaj periudhe për ndarje të barabartë të kohës së emitimit, në të gjitha mediat e vëzhguara, Qeveria kishte pjesën më të madhe në edicionet e lajmeve (së paku një të tretën e kohës kushtuar aktorëve politik). VMRO-DPMNE-së në pushtet dhe Lidhjes Social Demokrate të Maqedonisë (LSDM) në opozitë u kushtua shumë më shumë kohë se sa partive tjera politike në lajmet e servisit kombëtar MTV1 dhe kanaleve private televizive Sitel, Alfa dhe Kanal 5. Programet informative të televizionit A1 dhe Alsat-M siguruan pothuajse mbulim dhe hapësirë të njëjtë për VMRO-DPMNE, LSDM, BDI dhe PDSH. Televizioni publik MTV2 – i cili emiton kryesisht në gjuhën shqipe – raportimin e përqëndroi kryesisht në BDI-në (18 për qind) dhe PDSH-në (10 për qind), ndërsa raportimi dhe mbulimi i

qeverisë në lajmet e këtij televizioni ishte 44 për qind. Televizioni publik i paraqiti partitë qeveritare kryesisht në aspekt pozitiv, ndërsa LSDM-në portretizoi në dritë më negative.

Që nga fillimi i fushatës zyrtare më 2 mars, mediat elektronike kombëtare kanë siguruar raportim dhe mbulim të gjerë të fushatës. Mediat u kanë dhënë hapësirë të shtatë kandidatëve për president, por, deri më tani lajmet kanë tendencë t'u japin hapësirë më të madhe kandidatëve të cilët konsiderohet të kenë përparësi në garë, përkaj kërkesave për të siguruar kohë të barabartë. Jashtë lajmeve, mediat prezantojnë informacione zgjedhore dhe nga fushatat në një numër të madh programesh. MTV1 siguron mbulim dhe paraqitje falas të kandidatëve për president, dhe gjithashtu ka rezervuar nga tre minuta kohë falas për kandidatët për kryetar komunash të cilët dëshirojnë t'i shfrytëzojnë ato. Mediat elektronike kombëtare emitojnë programe speciale zgjedhore, siç janë profilet e kandidatëve për president. Dy kanale televizive private kanë emituar debate mes shtatë kandidatëve presidencial. Megjithatë, raportohet që kandidati i partisë në qeveri të ketë thënë se nuk do të merr pjesë në debatet e mëtejshme.

Në përgjithësi, kanalet televizive kombëtare përqëndrojnë raportimin e tyre në zgjedhjet presidenciale, dhe jo aq në zgjedhjet lokale. Megjithatë, televizionet kombëtare si Alsat-M dhe MTV2 organizuan programe ku u paraqitën kandidatët për kryetar komunash në komunat të banuara kryesisht me Shqiptarë etnik, dhe televizioni kombëtar Telma emitoi një debat mes kandidatëve për kryetar të Shkupit. Mbulesa e fushatës në mediat lokale ishte e kufizuar gjatë javës të parë, por disa media lokale thanë se planifikojnë të emitojnë programe zgjedhore, duke përfshirë edhe debate mes kandidatëve për kryetarë të komunave, përveç kontributeve që kanë të bëjnë me zgjedhjet në kuadër të lajmeve.

Deri tani, vetëm disa parti kanë përdorur në masë të madhe reklamën politike me pagesë. VMRO-DPMNE qartë dominon në reklamën politike të paguara që emitohej në TV A1, Kanal 5 dhe Sitel. LSDM ka emituar reklama zgjedhore kryesisht në Alfa TV, ndërsa BDI dominon në reklamën e paguara në TV Alsat-M.

V. ANKESA DHE APELE

Gjykata Administrative ka sjell, brenda afateve ligjore, 12 vendime për aktпадi për shkelje lidhur me regjistrimin e kandidatëve. Gjykata pranoi katër aktпадi dhe refuzoi gjashtë, ndërsa dy u tërhoqën nga ankuesit. Pesë nga gjashtë aktпадitë u refuzuan për arsye procedurale, që tregojnë se disa kandidatë nuk i njohin mirë kushtet dhe kërkesat procedurale. Gjykatësit e Gjykatës Administrative morrën pjesë në disa trajnime të organizuara për të lehtësuar transferin e përvojës nga Gjykata Supreme në atë Administrative në lidhje me zgjidhjen e rasteve që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

Hetuesitë gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së I-rë në Shkup, të iniciuara nga Këshilli për Radiodifuzion kundër disa mediave për shkelje të nenit 74.1 të Kodit Zgjedhor (në lidhje me shkelje të rregullave të transmetimit para fillimit të fushatës zyrtare) kryesisht janë shtyrë për mesin e muajit mars ose akoma nuk janë caktuar për shkak të vonësës në grumbullimin dhe kompletimin e dokumenteve. Më tej, dy aktпадi që i paraqiti KShZ-ja për zhvillim të fushatës para fillimit të periudhës së fushatës zyrtare akoma po presin që Gjykata e Shkallës të Parë t'i marrë në shqyrtim. Prolongime të tilla në gjykatë në raste që kanë rëndësi kohore pengojnë zbatimin e rregullave zgjedhore dhe të drejtën e pjesëmarrësve në zgjedhjet për të pasur mjet ligjor efikas.

KShZ-ja ka adoptuar udhëzime se si duhet të zgjidh ankesat e paraqitura para tij.

VI. PJESËMARRJA E GRAVE DHE PAKICAVE NACIONALE

Vetëm 14 gra garojnë për kryetar komunash nga gjithsej 374 kandidatura (3.7 për qind); ato garojnë në 11 komuna. Vetëm katër nga partitë e përfaqësuara në Kuvend, VMRO-DPMNE, LSDM, Partia Liberal Demokrate dhe Partia Liberale vendosën të nominojnë kandidatë gra për postin e kryetarit të komunës. Megjithatë, partia më e vogël, Partia e Demokratëve të Bashkuar të Maqedonisë (PODEM), ka pesë kandidate gra për kryetar komune. Kushti që secila gjini të përfaqësohet me së paku 30 për qind në stafin e KZK-ve është respektuar, dhe nuk janë paraqitur ankesa formale në lidhje me këtë. Sipas të dhënave të KShZ-së, 57 KZK (67 për qind) kanë më tepër se tre gra nga gjithsej dhjetë anëtarë dhe zëvendës anëtarë, dhe 30 KZK (35 për qind) udhëhiqen nga gra.

UNDP (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim) do të zbatojë trajnim të anëtarëve të KZ-ve në më tepër se 24 komuna me qëllim parandalimin e votimit familjar dhe votimit për dikë tjetër. Disa OJQ gjithashtu po organizojnë edukim të votuesve që të zvogëlojnë votimin familjar në rajone të ndryshme të vendit, duke përfshirë Prilepin, Tetovën dhe Sveti Nikolen.

Vëzhguesit afatgjatë të MVZ të OSBE/ODIHR kanë njoftuar për pjesëmarrje të ulët të femrave në ngjarjet zgjedhore, veçanërisht në pjesët perëndimore të vendit. Në të shumtën e aktiviteteve zgjedhore pjesëmarrësit janë krejtësisht meshkuj. Në përgjithësi, gratë duket se nuk kanë pozita të forta vendimmarrëse në partitë politike, dhe partitë politike nuk duket se po bëjnë përpjekje të veçanta për të tërhequr votueset nga gjinia femrore.

Dispozitat ligjore për përfaqësim "adekuat dhe të drejtë" të komuniteteve etnike në KZK-të janë respektuar. Në të gjitha 32 komunat ku popullata që i përket komuniteteve etnike minoritare është 20 për qind apo më tepër, kryetari apo nënkryetari i përket atij grupi etnik. Diku rreth 33 kandidatë për kryetarë komunash u takojnë komuniteteve etnike më të vogla. Shumica nga ta u takojnë partive që përfaqësojnë grupin etnik përkatës; vetëm pesë nga këta kandidatë garojnë në listat e partive të mëdha. Për më tepër, ka gjashtë kandidatë të pavarur për kryetar komunash nga komunitetet etnike më të vogla. Ka sinjale për atmosferë të tensionuar në disa komuna ku garojnë parti të ndryshme të grupit etnik të njëjtë. Liderët dhe kandidatët për kryetar komunash të dy koalicioneve të partive Rome lëshuan një deklaratë të përbashkët publike ku zotohen se do të sillen në mënyrë të drejtë gjatë periudhës zgjedhore.

VII. AKTIVITETET E MVZ-SË TË OSBE/ODIHR

Gjatë periudhës së raportimit, MVZ i OSBE/ODIHR vazhdoi me aktivitetet e rregullta. Shefi i Misionit dhe anëtarët e tjerë të ekipit qëndror zhvilluan takime me Presidentin, Qeverinë, ministrat, zyrtarë shtetërorë, administratën zgjedhore, zyrtarë gjyqësorë, përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile, dhe misione diplomatike. Vëzhguesit afatgjatë të vendosur në gjithë territorin e vendit vazhdojnë të vëzhgojnë përgatitjet zgjedhore dhe fushatën në rajonet e tyre përkatëse dhe po përgatiten për vendosjen e vëzhguesve afatshkurtër. Më 26 shkurt u mbajt një takim informativ me përfaqësuesit e komunitetit diplomatik dhe organizatat ndërkombëtare të akredituara në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. MVZ i OSBE/ODIHR do të përforcohet me rreth 250 vëzhgues afatshkurtër që do të vëzhgojnë në ditën e zgjedhjeve.